



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Bordi i Regjistrimit dhe Licencimit/Bord za Registraciju i Licenciranje/ Registering and
Licencing Board

Datë: 04.04.2016

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 20 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, nenit 24, 25 dhe 26 të Statutit të Përkohshëm të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë dhe nenit 26,27 dhe 28 të Rregullores mbi Procedurat e kandidimit dhe zgjedhjes së antarëve të organeve të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë, Kuvendi i Odës së Infermierëve i mbajtur me datën 23.01.2015, bazuar në rezultatin zgjedhor për Kryetar të Odës, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet raporti i Komisionit Qendror Zgjedhor për procesin e zgjedhjes së z. Naser Rrustemi për Kryetar të Kuvendit të Odës së Infermierëve të Kosovës.
2. Mandati i Kryetarit të Odës është ekuivalent me mandatin e antarëve të Kuvendit të Odës.
3. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Odës.

Arsyetim

Komisioni Qendror Zgjedhor për zgjedhjen e antarëve të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, duke zbatuar procedurat për zgjedhjen e kryetarit të Odës së Infermierëve të Kosovës të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Statutin e Përkohshëm të Odës së Infermierëve të Kosovës dhe Rregulloren për procedurën e kandidimit dhe zgjedhjes së organeve të Odës së Infermierëve të Kosovës, ka njoftuar Kuvendin për procesin zgjedhor për Kryetar të Odës dhe rezultatet e votimit. Kuvendi i Odës së Infermierëve të Kosovës, njezëri ka miratuar raportin e KQZ-së për zgjedhjen e z. Naser Rrustemit për Kryetar të Odës së Infermierëve të Kosovës.

Hysni Bajrami
Kryetar i KQZ

I dërgohet :

Ministrit të MSH-së
Kryetarit të Odës
Arkivës

